



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstva Prade - Ministry of Justice

SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS - PROBACIONA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO PROBATION SERVICE

Drejtoria Rajonale në Pejë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA KLINË
OF KLINA
11.11.23
Nr. Nr.: 116-11631/23
Data-Data-Datum 03.04
Klinë-Klina

EMRI I INSTITUCIONIT

Komuna e Klinës

(tel 039 471 306)

EMRI I UDHËHEQËSIT TË INSTITUCIONIT

Zenun Glezaj

PËR SHËRBIMIN SPROVUES

HAXHI BERDENAJ

(tel. 039/432-641 ; 044-425-385)

DATA

03.04.2023

VENDI

Klinë



Shërbimi Sprovues është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili është përgjegjës për Ekzekutimin e Masave dhe dënimeve alternative. Këto masa dhe dënime alternative janë të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) përkatësisht në kapitullin e III-të, neni 46, ku parashihen dënimet alternative, si dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Kosovës (KDM), përkatësisht në Kapitullin e IV, ku parashihen masat e diversitetit; në Kapitullin V ku parashihen masat edukative dhe në Kapitullin VI, neni 32 ku parashihet edhe dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme (UPDP).

Për ekzekutimin e këtyre masave dhe dënimeve alternative, Shërbimi Sprovues i Kosovës është i detyruar të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe ndërmarrje publike, në mënyrë që personat e dënuar me dënim alternativ (punë në dobi të përgjithshme), t'i dërgon në institucionet/ndërmarrje të tilla, në kuptim të nenit 57. par. 2 të KPRK-së, dhe neni 32 par.1 të KDM-së.

Orët e punës pa pagesë që do t'i kryejnë klientët, do t'i caktoj gjykata me vendim dhe atë prej 30 deri 240 orë pune në dobi të përgjithshme për madhorë dhe prej 30 deri 120 orë pune në dobi të përgjithshme për të mitur. Mënyrën dhe kohën e shpërndarjes së këtyre orëve do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në bashkëpunim me institucionin përkatës.

Kontaktet në mes të Shërbimit Sprovues dhe institucionit do të jenë të vazhdueshme deri sa klienti i kryen orët e punës (obligimin), sipas vendimit të Prokurorisë / Gjykatës.

Detyrat dhe obligimet e palëve

Shërbimi Sprovues

- Shërbimi sprovues përmes Zyrës rajonale përgjegjëse, cakton një zyrtar sprovues, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masës apo dënimit alternativ;
- Organizimin e takimit me klientin dhe personin përgjegjës nga institucioni, për qëllime organizative për ekzekutimin e masës/dënimit;
- Dhënia e detyrave të dobishme (të punës) që nuk janë degraduese për të dënuarin;
- Sigurohet se çdo gjë shkon ashtu siç është e paraparë;
- Intervenimi, në rastet kur klienti ose personi përgjegjës e kërkon këtë;
- Përgatitja e një vlerësimi cilësor e sasior, në fund të programit, së bashku me personin përgjegjës të institucionit ku kryhet puna dhe klientin;
- Dorëzimi i raportit gjykatës/prokurorisë, me rastin e përfundimit të obligimit (urdhëresës) për klientin;

Klienti

- Duhet që ta respektoj orarin e punës dhe detyrat e dhëna;
- Duhet që t'a informoj personin përgjegjës të institucionit ku kryhet puna dhe zyrtarin sprovues, në rast se paraqitet ndonjë problem;
- T'a arsyetoj çdo mungesë;
- Mos të shkaktoj kurrfarë dëmtimi (material ose moral) të institucionit publik;
- Mos të huazoj kurrfarë material që i përket institucionit publik;
- Të silllet në mënyrë korrekte (i sjellshëm, i saktë, përgjegjës, etj.);
- Nëse ka vështirësi duhet që të bisedojë me personin përgjegjës të institucionit ose zyrtarin sprovues, me qëllim tejkalimi të vështirësive;

Institucioni/Ndërmarrja publike

- Institucioni/ndërmarrja publike ka për detyrë që në fillim t'ia caktoj klientit një person përgjegjës (mbikëqyrës),
- Të mbikëqyrë punën e klientit më për së afërmi, respektimin e orarit dhe detyrave të dhëna për klientin, deri në përfundim të obligimit sipas vendimit të gjykatës/prokurorisë;
- Të siguroj kujdesin ndaj klientit me pajisje adekuate për vendin e punës, ku kryhet puna;
- Mos ta ekspozoj klientin në situata të rrezikshme (për klientë fëmijë duhet respektohet neni 32 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve);
- Ti ndalojë klientit ngasjen e mjeteve motorike;
- Të kujdeset që klienti të mbetet anonim.
- Me kryerjen e obligimit nga ana e klientit, personi përgjegjës nga institucioni ku kryhet puna, ka për detyrë të nënshkruaj dokumentin me të cilin vërteton dhe e vlerëson se si është kryer puna.